



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:003044

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05486340

C.nr.211/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtares Elvira Emini, si gjyqtare individuale, në çështjen juridike kontestimore të propozuesve të sigurimit R. F. dhe M. F. që të dy nga fsh. P. k.Lipjan, kundër kundërshtarëve të sigurimit D. K. nga fsh. R. i R. K.Lipjan, tani me adresë të panjohur, dhe M. K. nga fsh. R. i R. K.Lipjan, tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë me propozim për caktimin e masës së sigurisë, jashtë seance me dt.16.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET I TËRHEQUR**, propozimi për caktimin e masës së sigurisë, I parashtruar nga propozuesit R.F. dhe M. F. që të dy nga fsh. P. k.Lipjan, kundër kundërshtarëve të sigurimit D.K. nga fsh. R. i R.K.Lipjan, tani me adresë të panjohur, dhe M. K. nga fsh. R. i R. K.Lipjan, tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë me propozim për caktimin e masës së sigurisë, në këtë çështje juridike kontestimore.
- II. DETYROHEN** palët propozuese që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore për taksë gjyqësore për propozim, kësaj gjykate t'ia paguajë shumën prej 20-€, në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit nën kërcënimin e përmbartimit me detyrim.

A r s y e t i m

Propozuesit, me datën 04.01.2024 pranë kësaj gjykate kanë parashtruar propozim kundër kundërshtarëve të sigurimit, me objekt të çështjes caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Me aktvendimin e dt. 15.01.2024, gjykata propozuesve të sigurimit ua ka kthyer në plotësim dhe rregullim propozimin, në kuptim të dispozitës së nenit 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së, ashtu që propozuesit e sigurimit i ka detyruar në drejtim të precizimit të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë duke e përcaktuar qartë petitumin e propozimit për masë të përkohshme të sigurisë, ta përcaktojë bazën juridike të kërkesës për masë, ta përcaktojë vlerën e kontestit, të gjitha në afatin prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në të kundërtën propozimi i propozuesve të sigurimit do të konsiderohet si i tërhequr.

Propozuesit e sigurimit nuk i janë përmbajtur aktvendimit të marrë nga kjo gjykatë me dt.15.01.2024, edhe përkundër faktit se nga shkresat e lëndës vërtetohet se propozuesit e kanë pranuar aktvendimin e gjykatës me datën 05.02.2024.

Në bazë të nenit 102.3 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet se “do te konsiderohet e tërhequr parashtrësia po qe se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit te caktuar, e ne qofte se kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht e pa plotësuar do te hedhet poshtë”.

Gjykata vlerëson se propozuesve iu është dorëzuar aktvendimi konform nenit 112 të LPK-së, dhe meqenëse të njëjtit nuk kanë vepruar brenda afatit të përcaktuar nga gjykata, respektivisht nuk e kanë plotësuar propozimin, sipas aktvendimit të lartshënuar, andaj në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, gjykata propozimin e propozuesve të sigurimit e konsideroi si të tërhequr.

Gjyqtarja e çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 102.3 dhe 387 pika c të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMEORE NË PRISHTINË -DEGA NE LIPJAN
departamenti i Përgjithshëm
C.nr.211/24 me dt. 16.02.2024

G J Y Q T A R J A
Elvira Emini

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2024:003044
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05486340